

**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
TRIFOLIUM Sh.P.K.**

Në Tiranë, sot më datë 22 Qershor 2021, shtetasit:

Znj. **Najada Sotir Kambo**, e lindur më 19 Nëntor 1996, në Korçë dhe banuese në Rrugën Medar Shtylla, Komuna e Parisit, Tiranë, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, mbajtëse e Kartës së Identitetit me numër 032647736 dhe numër personal J66119056B madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Z. **Ori Arben Hoxha**, i lindur më 7 Gusht 1994, në Tiranë dhe banues në Rrugën Isa Boletini, Nr.28, Tiranë, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, mbajtës i Kartës së Identitetit me numër 031587938 dhe numër personal J40807054B, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Z. **Rexhino Gëzim Çekrezi**, i lindur më 01.10.1993 në Belsh dhe banues në Rezidencën Rolling Hills, Villa 11, Lundër, Tiranë, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, mbajtës i Kartës së Identitetit me numër 034528799 dhe numër personal J31001102S madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Z. **Admir Baftjar Malaj**, i lindur më 17 Maj 1983, në Elbasani dhe banues në Sheshi Hari Trumen, Nd.1, H.42, Ap.5, Tiranë, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, mbajtës i Kartës së Identitetit me numër 034473513 dhe numër personal I30517102S, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Të cilët duke u bazuar dhe në përputhje me Ligjin nr.9901, datë 14 Prill 2008, “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare”, i ndryshuar, si dhe legjislacionin në Republikën e Shqipërisë, ka/në vendosur të themeloj/në një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë “Shoqëria”), me dispozitat e mëposhtme.

NENI 1

Emërtimi dhe selia e shoqërisë

Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është **TRIFOLIUM Sh.P.K.**

1.1 Selia e shoqërisë ndodhet në është: Rruga Petro Nini Luarasi, P. Dolçka, K. II (Tek ish-Tregu Elektrik), Tiranë, Shqipëri. Në këtë adresë ndodhet edhe Zyra Qendrore e Shoqërisë.

1.2 Shoqëria mund të hapë degë dhe zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

NENI 2

Objekti i Shoqërisë

2.1 Objekti i Shoqërisë është :

i. Aktivitet në fushën e prodhimit, blerjes dhe shitjes së software (programeve kompjuterike dhe zgjidhjeve teknologjike nëpërmjet programimit), dizënjim programim (kodim) dhe zhvillim, projektim i detajuar i faqeve web, aplikacioneve mobile, software dhe bazave të të dhënave, analizë, integrim i përbërësve (komponenteve), trajnime mbi produktet software, instalime, konsulenca, zbatime dhe aktivitete të tjera ndihmëse në fushën e teknologjisë dhe dixhitalizimit përtej industrisë përkatëse, ndjekje të proceseve, kolaudim, korigjim, deri në produktin përfundimtar duke realizuar zgjidhje, plotesime të sistemit informatik me elementet e sigurisë, privatësisë etj.

ii. Blerje dhe shitje të pajisjeve hardware, kompjutera, aksesorë dhe pjesë të tyre, instalim e mirembajtje te tyre.

iii. Kurse profesionale, këshillim karriere, ndërmjetësim punësimi dhe shërbime të tjera të tregut të punës të lidhura kryesisht me fushën e shkencave kompjuterike dhe teknologjisë, por dhe më gjërë, në sektorë të tjerë përtej kësaj industrie.

iv. Import/eksport të mallrave dhe shërbimeve sipas nënplikave i, ii dhe iii të pikës 2.1 të këtij neni.

2.2 Shoqëria, për të arritur objektivat e përcaktuara mund të bashkëpunojë direkt dhe indirekt me shoqëri të tjera shqiptare dhe/ose të huaja që kanë objekt të njëjtë, të ngjashëm dhe/ose të lidhur me të tyren.

NENI 3

Kohëzgjatja e Shoqërisë. Viti ushtrimor

3.1 Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj për një afat kohor te pacaktuar.

3.2 Viti i parë financiar do të fillojë nga momenti i regjistrimit të shoqërisë në regjistrin tregëtar, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) Tiranë dhe do të përfundojë në 31 Dhjetor të atij viti.

3.3 Vitet e mëtejshme financiare fillojnë më 1 Janar dhe përfundojnë me 31 Dhjetor të çdo viti.

NENI 4

Kapitali themeltar

4.1 Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100,000 Lekë (Njëqindmijë Lekë) dhe përbëhet e gjitha nga kapital në para. Pjesëmarrja e Ortakeve themelues në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

i. Ortakuja themelues Znj. Najada Kambo zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 2,100 (Dy mijë e njëqind) Lekë që përben 2.1 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

ii. Ortaku themelues Z. Ori Hoxha zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 39,300 (Tridhjetë e nëntë mijë e treqind) Lekë që përben 39.3 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

iii. Ortaku themelues Z. Rexhino Çekrezi zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 29,300 (Njëzet e nëntë mijë e treqind) Lekë që përben 29.3 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

iv. Ortaku themelues Z. Admir Malaj zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 29,300 (Njëzet e nëntë mijë e treqind) Lekë që përben 29.3 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

4.2 Kapitali themeltar perbehet nga 4 (Katër) kuota me vlerë nominale sipas pikës 4.1 të këtij neni dhe vlerë të përgjithshme prej 100,000 Lekë (Njëqindmijë Lekë) të marra sëbashku.

NENI 5

Asambleja e Përgjithshme

5.1 Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e përcaktuara në Ligjin nr.9901, datë 14 Prill 2008, "Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare", i ndryshuar. Asambleja e përgjithshme mblidhet në rastet dhe sipas mënyrës së thirrjes të përcaktuara në statusin e shoqërisë.

NENI 6

Administratori

6.1 Shoqëria do të administrohet nga një Adminstrator.

6.2 Administrator i vetem i shoqërisë për një mandat 6 (Gjashtë) mujor, me te drejte ripërteritje, do të jetë **Znj Najada Sotir Kambo**, e lindur më 19 Nëntor 1996, në Korçë dhe banuese në Rrugën Medar Shtylla,



Komuna e Parisit, Tiranë, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, mbajtëse e Kartës së Identitetit me numër 032647736 dhe numër personal J66119056B madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

6.3 Si rregull, afati i emërimit është 3 (Tre) vjet me të drejtë ripërtëritjeje, ndërsa në momentin e themelimit, administratori i parë ka një mandat 6 (gjashtë) mujor.

NENI 7

Kostot e themelimit

7.1 Të gjitha kostot, pagesat dhe shpenzimet lidhur me themelimin dhe regjistrimin e shoqërisë do të merren përsipër nga shoqëria, të cilat do të përfshihen në llogarinë e parë vjetore financiare në shumën e atyre aktuale.

NENI 8

Njoftimet

8.1 Njoftimet për oratakët do të kryhen me postë, të regjistruar në adresën më të fundit të komunikuar nga çdo ortak, me përjashtim kur parashikohet ndryshe nga ligji apo statuti.

8.2 Njoftimi mund të bëhet edhe nëpërmjet postës elektronike, në momentin e krijimit të kushteve teknike që kërkohen sipas ligjit.

NENI 9

Dispozita të fundit

9.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje me këtë akt themelimi, me statutin e saj dhe legjislacionin në Republikën e Shqipërisë.

NENI 10

Kopje

10.1 Ky akt themelimi hartohet në 6 (Gjashtë) kopje, sipas këtij destinacioni, një kopje për çdo ortak, një kopje për Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe një kopje për zyrën qendrore të shoqërisë.

ORTAKËT

E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR


TRIFOLIUM Sh.P.K.

Znj. Najada Kambo



.....

Z. Ori Hoxha




.....

Z. Rexhino Çekrezi



.....

Z. Admir Malaj



.....